



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
NJËSIA E PROKURIMIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje për mobilim të zyrave ”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
39130000-2**

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,276,000 lekë (pesë milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë lekë) pa TVSH, fond i përcaktuar nga testimi i tregut me marrjen e tre ofertave nga operatorë ekonomikë që veprojnë në treg në fushën objekt prokurimi.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Enti Rregullator i Energjisë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin Vërtetim nga Drejtoria Tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024). Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros për të paktën në një nga tre vitet e fundit financiar duhet të jetë jo më e vogël **se 40% e vlerës së fondit limit** të kontratës që prokurohet

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, pika 3, e LPP, nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe pikës 7 të Rekomandimit nr.7998 prot. datë 24.12.2021 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikimin për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”. Vendosja e këtij kriteri i shërben AK për të vërtetuar se operatori ekonomik i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën objekt të prokurimit si dhe për t’u njohur me gjendjen ekonomike të OE për tre vitet e fundit.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Dëshmi për përvoja të mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë sa 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës (fondit limit)

- Kur përvoja e mëparshme është realizuar me ente publike, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Vërtetim/e të lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose / dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Kur përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur faturën/faturat tatimore të shitjes ku janë shënuar datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe pikës 4/b të nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi, çka rrit besueshmërinë të Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST dhe dispozitat e kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 3 (tre) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e OE në momentin e hapjes së ofertave, me kualifikimet si më poshtë:

- 1 (një) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh
- 2 (dy) Punonjës të thjeshtë për proceset ndihmëse të punës

Punonjësit e sipërmendur duhet të kenë aktualisht një marrëdhënie pune me operatorin ekonomik prej jo më pak se 2 (dy) muaj, e vërtetuar kjo me paraqitjen e: - Kontratave të punës dhe - Formularëve E-sig të Listë pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore të 2 (dy) muajve të fundit (qershor-korrik), të konfirmuara pranë organeve tatimore.

***Shënim:** Kriteri nr.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Dokumentat e kërkuara më sipër (Kontratë pune dhe Listëpagesa) do të paraqiten në rast se operatori ekonomik kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, duke garantuar që produktet e ofruara të jenë cilësore, jetëgjatë, dhe në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesa e AK për 1 (një) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh është vendosur patur parasysh që ky specialist ka njohuri të duhura që kanë të bëjnë me përpunimin dhe montimin e saktë të pjesëve të mobiljeve. Ai është i aftë të zbatojë me saktësi udhëzimet teknike dhe të sigurojë që çdo pjesë e montuar të jetë në përputhje me specifikimet e kërkuara, duke shmangur gabimet që ndikojnë në cilësinë dhe jetëgjatësinë e mobiljeve, duke ulur rrezikun e defekteve dhe problemeve gjatë përdorimit.

Kërkesa e AK për 2 (dy) punonjës të thjeshtë është vendosur duke patur parasysh që ata janë të domosdoshëm për proceset ndihmëse gjatë zbatimit të kontratës, siç mund të jenë në ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave apo edhe gjatë procesit të montimit të tyre.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;
- ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalent;
- ISO 45001 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” (e vlefshme) ose ekuivalent.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Certifikimi ISO 9001 ose ekuivalent i shërben AK për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese. Përmbushja e

standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron manaxhimin e cilësisë së mallrave objekt prokurimi. Ky lloj certifikimi garanton AK se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për produktet e ofruara dhe zbatimin e kontratës sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

Certifikimi ISO 14001 ose ekuivalent i shërben AK për të garantuar se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masat e duhura me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Certifikimi ISO 45001 ose ekuivalent është një standard ndërkombëtar që specifikon dhe përcakton kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ky certifikim i shërben AK për të vërtetuar se OE ka siguruar dhe marrë masat e duhura për të menaxhuar në mënyrë sistematike rreziqet që mund të vijnë në vendin e punës; ulja e incidenteve dhe lëndimeve në vendin e punës; Përkushtim i OE për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve pjesë e stafit të tij.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë / skedë teknike për të gjithë artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike për secilin artikull, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të vlerësojë përputhshmërinë me specifikimet teknike të artikujve me ato të kërkuara në DST. Nëse katalogët / skeda teknike janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6 germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter i shërben AK për të vërtetuar dhe garantuar që mallrat e ofruar nga OE janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të kërkuara nga AK në DST.

5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se nuk është prodhues i pajisjeve të mobilimit, duhet të paraqesë një deklaratë ku të përcaktohet kompania prodhuese e mobiljeve dhe vendi i origjinës.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve objekt prokurimi, e cila duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit nga data e dorëzimit të mallit, periudhë gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin (pa pagesë), të defekteve që kanë ardhur për shkak të prodhimit dhe/ose montimit.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron që merr përsipër shërbimin e transportit dhe montimin e mallrave pranë ambjenteve të Entit Rregullator të Energjisë brenda afatit të parashikuar në këto DST.

Gjithashtë në këtë deklaratë ai duhet të deklarojë se disponon mjet transporti për realizimin e transportit të artikujve. Në deklaratë OE duhet të japi të dhëna për llojin e mjetit, targën, kapacitetin mbajtës të tij dhe statusin e mjetit (pronësi/qira/përdorim)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, pika 6/a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtyre kriterëve (deklaratave) kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe deklarojnë që kanë përvojën dhe kapacitetet e nevojshme për të zbatuar kontratën, dhe se mallrat që ata do të ofrojnë janë cilësore, të garantuara për qëllimin e tyre dhe në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e vendosura nga AK. Gjithashtu këtë kriterë shërbejnë për provuar që OE ka në stafin e tij punonjësit e kërkuar, dhe ata janë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi, për të provuar vazhdimësinë e marrëdhënies së tyre të punës pranë OE.

Këto kriterë janë një garanci për AK që OE do të përmbushë kontratën me kapacitetet njerëzore dhe teknike përkatëse, brenda kushteve dhe afateve të përcaktuara nga AK.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Emërtimi i Artikujve	Përshkrimi i Artikujve	Përmasat	Sasia	Njësia
----------------------	------------------------	----------	-------	--------

1. Tavolinë pune rang drejtuesi në formë L-je	Tavoline pune drejtuesi (titullari) 280x235cm me lartësi 76cm. Tavolina duhet të jetë e përbërë nga dy pjesë; tavolina e punës dhe tavolina e kompjuterit. Tavolina e punës duhet të jetë me përmasa 280x115cm në të dy skajet e tavolinës. Tavolina e kompjuterit duhet të ketë përmasa 118x60cm. Tavolina duhet të jetë me material MDF në lyerje. Syprina e tavolinës duhet të jetë me përmasa 280x115cm në të dy skajet dhe në qendër 105cm. Trashësia e syprinës duhet të jetë 9cm. Syprina duhet të jetë e ndarë në 3 pjesë, ku 2 pjesët anësore duhet të kenë përmasa 70x115cm në krahun e jashtëm dhe 70x105cm në krahun e brendshëm. Pjesa qendrore duhet të jetë me përmasa 140x105cm. Në pjesën qendrore duhet të jenë të hapura 2 vrima për kalimin e kabujve nga lart-poshtë dhe anasjelltas me përmasa 15x7cm. Në pjesën qendrore syprina e tavolinës duhet të ketë veshje tapicerie 140x49cm. Në pjesën e pasme duhet të ketë një sirtar me shinë që shërben për mbajtjen e sendeve. E gjithë syprina e tavolinës në perimetrin e bordurës duhet të ketë një punim dekorativ në të gjithë përmasat e saj nga 2 në 2.5cm. Pjesa ballore e dukshme duhet të jetë 5.5cm deri në 6cm. Tavolina duhet të mbështetet në 2 këmbë me përmasa 95x61x68cm dhe pjesa bashkuese 136x68cm. Këmba në të gjithë gjatësinë e saj duhet të ketë ka një bordurë të punuar. Mbi lartësinë e bordurës 17cm deri në lartësinë 44cm duhet të ketë një punim dekorativ me lëkurë të veshur në të gjithë gjatësinë e saj. Në pjesën e përparme të këmbës duhet të ketë një kthim 45 gradë që shërben për bashkimin e 2 këmbëve në pjesën bashkuese. Tavolina nga Brenda duhet të ketë 2 këmbë të fshehta me përmasa 40x7x68cm. Pjesa bashkuese në po të njëjtën lartësi me këmbën me lartësi 16cm nga bordura, duhet të ketë një punim dekorativ me veshje lëkure ekologjike deri në lartësinë 44cm. Tavolina e kompjuterit me përmasa 120x60x76cm. Tavolina e kompjuterit duhet të jetë në të njëjtën lartësi me tavolinën e punës. Tavolina e kompjuterit duhet të ketë dizajno të njëjtë si tavolina e punës me përmasa 108x51cm bordura, ndërsa pjesa tjetër të jetë 101x45cm. Në pjesën e jashtme në lartësi 16cm deri në 44cm duhet të ketë një punim me lëkurë ekologjike. Në pjesën e brendshme tavolina e kompjuterit duhet të ketë një kanate me përmasa 53x36cm, një sirtar me përmasa 58x20cm, një hapësirë boshe 20cm dhe sipër kësaj vendi i	280 CM x 235 CM x Lartësi 76 CM	1	Copë
--	--	---------------------------------	---	------

	tastierës. E gjithë tavolina duhet të jetë material MDF në lyerje dhe montimi tavolinës duhet të jetë i fshehtë.			
--	---	--	--	--

	2.Tavolina e punës (drejtuesi) në formë L-je duhet të jetë e përbërë nga 2 pjesë, nga tavolina e punës dhe tavolina e kompjuterit. Tavolina e punës duhet të jetë 180x86cm dhe tavolina e kompjuterit duhet të jetë 168x50x64cm. Syprina e tavolinës duhet të jetë me permasa 180x86x3cm. Syprina në pjesën e përparme duhet të ketë një punim në forme trekëndëshi me gjatësi 2.5cm. pjesa lidhëse e këmbës me tavolinën e kompjuterit duhet të jetë 155x40cm. Këmba e tavolinës në njërin krah duhet të ketë përmasa 86x75cm. Në pjesën fundore të këmbës duhet të ketë një punim në formë drejtëkëndore me permasa 49x5cm që shërben për ti dhënë një konfiguracion të plotë tavolinës. Në krahun e këmbës së tavolinës duhet të montohet një sirtar 42x14cm. Trashësia e këmbës duhet të jetë 3cm. Në krahun tjetër duhet të ketë një këmbë mbështetëse me përmasa 86x12x3cm. këmba duhet të ketë një punim drejtëkëndor të njëjtë me syprinën e tavolinës me një punim 3 cm. Bashkimi i syprinës me këmbët e tavolinës duhet të realizohet me 45 gradë që bashkimi të ketë 5mm hapësirë të dukshme të këmbëve 168x50x53cm. Tavolina e kompjuterit duhet të mbështetet në 2 këmbë md f 8x40x11cm. E gjithë tavolina e kompjuterit duhet të jetë e bashkuar 45 gradë. Duhet të ketë punim trekëndore me një thellesi 3cm si në pjesën e pasme ashtu edhe në pjesën e përparme. Struktura duhet të realizohet me md f të rimensuar vize në trashësi 3cm. Në pjesën e brendshme tavolina e kompjuterit të ketë një kanatë me përmasa 48x39cm dhe dy sirtarë 39x24cm me dorezë të fshehtë. Te dy sirtarët të janë të pajisur me brave me mbyllje automatike. Pjesa bashkuese e tetavolinës me komodinën duhet të ketë një pllakë MDF me përmasa 60x47cm që shërben për bashkimin e tavolinës së punës me tavolinën e kompjuterit. Tavolina e kompjuterit duhet të ketë te instaluar një grup me priza, vendin e usb-se dhe daljes se fishave te tjera me një distance 30cm nga fillimi i tavolines. I gjithë skileti i tavolinës së kompjuterit duhet të jetë i realizuar me MDF 3cm. Pjesa e pasme dhe e përparme duhet të realizohet me MDF 18mm. E gjithë tavolina duhet të jetë e realizuar me lyerje me rezistencë te lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Montimi i tavolinës duhet të bëhet me montim të fshehtë. Aksesorët e perdorur duhet të jenë cilësorë.	206 x 168 x 76 CM	3	Copë
--	--	-------------------	---	------

3. Tavolinë pune në formë L-je me Komodinë	Syprina e tavolinës duhet të formë trapezi e dale, ku njëri krah duhet të jetë I drejtë, ndërsa krahu tjetër duhet të jetë me punim oval. Pjesa e jashtme duhet të jetë 180x75x6cm dhe pjesa e brendëshme e tavolinës duhet të jetë 170x75x6cm. Syprina e tavolinës duhet të jetë e përbërë nga dy pjesë ku pjesa e poshtme e syprinës duhet të jetë e realizuar me material MDF në formë të harkuar me trashësi 4.5 cm. Pjesa e sipërme duhet të jetë e realizuar me material melaminë 1.5cm dhe e borduar me material PVC 2mm dhe trashësia e suprinës 6cm. Këmba në njërin krah duhet të jetë e harkuar në anen e jashtme duhet të jetë me përmasa 50x69x5cm dhe pjesa mbështetëse të jetë 45x69cm. Harku brenda këmbës duhet të ketë thellësi 2-3cm. Pjesa ballore e këmbës të jetë e harkuar në formë ovale ku pjesa para të jetë 25 cm dhe në mes 30cm dhe pjesa e poshtme 20cm. Këmba duhet të jetë një trup në formë ovale në mes edhe në të dyja skajet, me material MDF me lyerje. Trashësia e këmbës duhet të jetë 5cm. Tavolina e kompjuterit me përmasa 120x40x62cm. Struktura me melamine 1.6cm dhe bord PVC 1mm. Në të dyja anët e tavolinës duhet të jenë me material MDF me lyerje, me punim oval dhe përmasa 40x59x5cm.	180 x 130 x 75cm	10	Copë
4.Tavolinë pune me Komodinë	Tavolina e punës duhet të ketë syprinë me përmasa 120x60x2.5cm. Në pjesën e pasme dhe të përparme duhet të ketë një punim 45 gradë pas cm të pare, për ti dhënë tavolinës pamje ekskluzive. Suprina në njërin krah duhet të ketë një komodinë me përmasa 40x58x65cm. Komodina duhet të ketë një kanatë me përmasa 36x40cm. Kanata duhet të jetë me dorezë të fshehtë me të njëjtin punim si suprina e tavolinës me trashësi 16mm si dhe të ketë një sirtar me përmasa 36x15cm, I cili duhet të ketë çelës me kod. Komodina me syprinën duhet të bashkohet me një element bashkues me përmasa 48x32cm. Këmba tjetër duhet të jetë me përmasa 73x56x2.5cm. Pjesa bashkuese mes komodinës dhe këmbës duhet të jetë me përmasa 77x40cm. Në pjesën e sipërme të syprinës së tavolinës duhet të jetë e hapur një vrimë për kalimin e kabujve. Pjesa ballore duhet të montohet me gjatësi 22cm nga toka. Materiali i tavolines duhet të jetë melaminë cilesorë, kundër gërvishtjes dhe njollave. Tavolina duhet të jetë e realizuar nga kombinimi i syprinës me reliev bezhë në gri dhe pjesa mbajtëse gri. Komodina duhet të mbështetet me tapa plastike me lartësi 2.5cm për të evituar gërvishtjet gjatë përdorimit. Këmbët e	120 x 60 x 75cm	10	copë

	tavolinës duhet të jenë të pajisur me tapa plastike kundër gërvishtjes.			
5.Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, për 6 persona	Tavolina e mbledhjes duhet të ketë përmasa 240x120x76cm dhe të jetë e realizuar me material MDF në lyerje. Tavolina duhet të jetë e përbërë nga 2 pjesë, syprina dhe këmba. Syprina duhet të jetë në formë ovale me përmasa 240x120cm në qendër dhe 104cm në të dyja skajet. Trashësia e syprinës së tavolinës duhet të jetë 8.5cm. në të gjithë perimetrin e syprinës në lartësinë nga lartë-poshtë duhet të ketë një thyerje 1.2cm. 2 cm poshtë thyerjes duhet të ketë një punim dekorativ vizë me ngjyrë të zezë për ti dhënë pamje tavolinës. Këmbët e tavolinës duhet të jenë me të njëjtin material si syprina. Këmbet realizohen me bashkim të fshehtë me 2 këmbë në formë L-je 47x68x7cm. Këmbët duhet të jenë të pajisur me tapa plastike për të eliminuar gërvishtjet.	240 x 120 x 76cm	1	copë
6.Tavolinë mbledhje, për 4 persona	Tavolina duhet të jetë me përmasa 70x2.5x75cm. Syprina duhet të jetë prej materiali MDF të rimensuar njëllë me ngjyrë e tavolinave të punës me përmasa 70cm. Këmba duhet të jetë metalike ku bazamenti të jetë me përmasa 40x40cm, ndërsa pjesa lidhëse 6-8cm. Syprina të jetë me lyerje ngjyre sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.	70 x 2.5 x 75cm	4	copë
7. Banak për reception	Banaku i receptionit duhet të realizohet me material MDF në lyerje me përmasa 135x70x115cm. Pjesa e poshteme duhet të jetë me lartësi 88x70x135cm. Pjesa e sipërme duhet të jetë 26x25x133cm. Receptioni në pjesën e poshtem me duhet të ketë një punim 45cm MDF të rimensuar në të gjithë perimetrin e saj. Realizimi i bashkimit duhet të jetë 45 gradë	135 x 70 x 115cm	1	copë

8. Kolltuqe komplet (2+1+1)	Kompleti I kolltuqeve duhet të jetë 1-dysh dhe 2-tek. Kolltuku duhet të jetë me lëkurë ekologjike me përmasa: dyshi 160x73x73cm ku në pjesën e pasme të ketë një punim dekorativ me përmasa 60x37x1.5cm dhe në kokë 73x37cm. Pjesa tjetër duhet të jetë në formë ovale me krahët pak të dalë. Kolltuku duhet të jetë i vendosur mbi 4 këmbë metalike të kromuar. Kolltuqet tek duhet të jetë me përmasa 73x97x73cm ku në pjesën e pasme dhe anash të ketë një punim dekorativ me përmasa pas 97x37x1.5cm dhe në krahë 73x37x1.5cm. Pjesa tjetër e kolltukut të jetë një trup në formë ovale që mbështetet mbi 4 këmbë metalike të kromuar.	Divani 2-vendësh: 160 x 73 x 73 Kolltuqe tek 73 x 97 x 73cm	1	Komplet
9. Kolltuk njëvendësh	Kolltuku duhet të jetë i përbërë nga 2 krahë 71x60x11cm. Pjesa ulese duhet të jetë me përmasa 48x54cm. Pjesa mbështetëse duhet të jetë 70 x77cm në pjesën e sipërme dhe 70x50cm në pjesën e poshteme. Pjesa mbështetëse duhet të vijë në formë ovale ku në pjesën e sipërme duhet të ketë përmasa 11cm, ndërsa në pjesën bashkuese me ndenjësën duhet të ketë trashësi 17-18cm. Kolltuku duhet të mbështetet me këmbë plastike ose druri me lartësi 11-12cm. Kolltuku duhet të jetë i veshurë me lëkurë ekologjike të cilësisë së parë për të rezistuar sa më gjatë kohës.	78 x 71 x 80cm	7	Copë

10. Etazher	Etazheri duhet të ketë përmasa 310x220x39cm dhe duhet të jetë i përbërë nga 3 elemente: 2 etazhere me përmasa 94x220x39cm dhe biblioteka e hapur me përmasa 120x220x39cm. Etazheri duhet të jetë i përbërë nga bazamenti 91x11cm me punim dekorativ. Kapelja duhet të ketë përmasa 91x11cm në pjesën e poshteme dhe 93cm në pjesën e sipërme. Kapelja në pjesën e poshteme duhet të ketë një punim oval me trashesi 1.5cm, ndërsa në pjesën e sipërme duhet të ketë një kapele me trashesi 4cm nga e cila 1.5cm duhet të jenë të drejta dhe në pjesën e poshteme 2.5cm duhet të jenë me punim oval që ti japin pamje më solide etazherit. Etazheri duhet të ketë 4 kapakë, 2 në pjesën e poshteme me përmasa 78x40cm me punim dekorativ Brenda kapakeve. Në pjesën e sipërme duhet të ketë 2 kapakë me përmasa 120x40cm me xham, ku në pjesën e sipërme duhet të vijë me punim dekorativ në forme harku njëllor me pjesën e poshteme. Rafti duhet të ketë 2 kollona anësore me gjatesi 198x39x6.5cm. Pjesa e poshteme duhet të ketë një ndarje me mdf 2.5cm. Pjesa e sipërme duhet të ketë 2 ndarje me trashësi 2.5cm. Kolonat në pjesën ballore duhet të kenë një shirit druri të punuar me dekor nga lart poshtë. Biblioteka e hapur duhet të ketë përmasa 120x39x220cm. Biblioteka duhet të një bazament 127x11cm me punim dekorativ si pjesa e etazherit. Kapelja duhet të jetë 127x11cm me të njëjtat konfiguracione si etazheri. Në pjesën e poshteme duhet të ketë 2 kanata me përmasa 78x40cm dhe 3 sirtare me përmasa 26x40cm. 2 kanatat dhe blloku i 3 sirtarëve duhet të ketë të njëjtin punim si kanatat e poshteme të etazherit, punim të brendshëm dhe në pjesën e sipërme që vjen I harkuar. Në pjesën e sipërme të bibliotekës duhet të ketë 3 ndarje me mdf 120x38x2.5cm. Në hapësirën e pare nga poshtë duhet të jenë të vendosura 2 mdf me përmasa 38x38x2.5cm. Në ndarjen e dytë duhet të jenë të vendosura 2 mdf me përmasa 38x38x2.scm që shërbejnë për ti dhënë më shumë funksionalitet bibliotekës. E gjithë biblioteka duhet të jetë e realizuar me material mdf në lyerje. Ngjyra qershi. Kanatat duhet të realizohen me material mdf 1.8cm. i gjithë dollapi duhet të ketë montim të fshehtë. Dorezat e përdorura duhet të jenë cilësore dhe të përshtaten me etazherin.	310 x 220 x 39cm	1	Copë
--------------------	--	------------------	---	------

	11. Etazheri i zyrës duhet të ketë përmasa 240x160x40cm. I gjithë etazheri mbështetet mbi një bazament me të njejtin material me përmasa 230x30x5cm. Etazheri duhet të ketë të gjithë struktura e tij me MDF me trashësi 3cm e punuar në formë trekëndore me një thyerje 2.5cm. Në të gjitha bashkimet duhet të ketë një distance 0.3-0.5cm. Etazheri duhet të ketë 2 kanata me shine me përmasa 78x150x1.8cm. Në anën e brendëshme duhet të jetë i pajisur me gominë që shërben për të minimizuar përplasjet. Në pjesën e brendëshme duhet të ketë në të dyja anët 3 ndarje me përmasa 77x33x1.8cm, që krijojnë 4 hapësira. Në pjesën qëndrore duhet të ketë përseri 3 ndarje që krijojnë 4 hapësira ku e 2-ta dhe e 3-ta të jenë të ndara në mes për ti dhënë etazherit pamje solide. Materiali duhet të jetë MDF i rimensuar në komplet strukturën dhe me lysterje për kapakët që duhet të jenë të lyera me ngjyrë gri.	240 x 160 x 40cm	3	Copë
	12. Etazheri duhet të jetë i përbërë nga 2 anët me melaminë 16mm. Kapelja duhet të jetë me trashësi 2.5cm. Etazheri duhet të mbështetet me një xogël 8cm. Etazheri duhet të ketë 4 kapakë nga të cilët 2 kanatat e poshteme duhet të jenë me përmasa 71x38cm me melaminë 16mm si dhe të ketë një ndarje në mes me melaminë 1.6cm. Të jetë i pajisur me çelës për mbylljen e kanatave. Në pjesën e sipërme duhet të jetë i pajisur me kanata xhami me kornize alumini me gjerësi 5cm në të gjithë krahët. Xhami duhet të jetë transparent 4mm. Kanatat e aluminit nga pjesa e përparme duhet të kenë punim dekorativ. Pjesa e sipërme duhet të jetë e ndarë në 3 hapësira nga 2 ndarëse me trashësi 2.5cm. Kapakët duhet të jenë të pajisur me doreza cilësore. Aksesoret e përdorur duhet të jenë cilesorë. Etazheri duhet të montohet me punim të fshehtë. Dollapi duhet të vendoset mbi tapa plastike për të shmangur gërvishtjet	80 x 200 x 40cm	2	Copë
13.Dollap Metalik	Dollap metalik me 2 kanata me përmasa 92x45x200cm. Dollapi metalik duhet të jetë i realizuar me llamarinë 0.8mm. Dollapi duhet të mbështetet mbi një xogël 9cm. Struktura e dollapit duhet të jetë me trashësi 2.5cm në pjesën anësore dhe 3.5cm në pjesën e sipërme. Duhet të jetë i ndarë në 5 hapësira në brendësi. Kolonat duhet të jenë me vrima në menyre që të pershtaten me kërkesën e autoritetit kontraktor. Duhet të ketë 2 kanata me përmasa 43x187cm. Dollapi gjithashtu duhet të ketë një brave	92 x 45 x 200cm	2	Copë

	me çelës që shërben për mbylljen e dollapit. Dollapi duhet të vendoset mbi tapa plastike në menyre që të evitohen gervishtjet. Ngjyra duhet të jetë gri			
14.Komodinë me sirtarë	Komodina duhet të jete me strukture metalike me përmasa 50x39x60cm dhe duhet të ketë 3 sirtarë me përmasa 50x39x60cm që mbylljen me çelës me mbyllje qëndrore. Në të treja anët e komodinës duhet të jetë me material mdm me lysterje me ngjyrë. Trashësia e mdm duhet të jetë 1.8cm. Pjesa e sipërme e komodinës duhet të ketë përmasa 50x43cm dhe pjesët anësore duhet të kenë përmasa 48x55cm. Komodina duhet të mbështetet në 4 rrota plastike cilësore, kundra gërvishtjeve dhe zhurmave dhe me sistem frenimi.	50 x 39 x 60cm	5	Copë
15.Poltron rrotullues (drejtuesi) tip kolltuku	Karrigia duhet të jetë me përmasat 68x126x16cm. Karrigia duhet të jetë një trup, ndenjësja dhe mbështetësja. Karrigia duhet të jetë e ndërtuar me material druri. E gjithë pjesa e ndenjësës dhe mbështetësës duhet të jetë prej materiali Lëkure natyrale, ndërsa pjesa e pasme të jetë me lëkure ekologjike. Në të gjithë gjatësinë e trupit të karriges duhet të ketë punime dekorative. Në pjesën e poshteme të shpinës duhet të ketë një punim në formë ovale që shërben për të krijuar komoditet në ndenje. Përmasat e ndenjësës dhe mbështetësës duhet të jenë: 58x68x18cm ndenjësja, edhe 64x80x18cm mbështetësja. Karrigia duhet të jetë e pajisur me krahë druri me përmasa 52x30x6cm me punim dekorativ. Në pjesën e sipërme, krahë duhet të jetë i veshur me lëkurë të njëjtë si karrigia. Në krahun e djathtë duhet të ketë një levë që shërben për ulje-ngritje të karriges me anë të një pistoni me gaz. Në krahun e majtë duhet të ketë një tjetër mekanizëm që shërben për të çuar karrigen në pozicion relaksi para dhe mbrapa. Karrigia duhet të jetë e vendosur mbi një bazament metalik me 5 cepa, ku në fund duhet të janë të fiksuara rrotat e lëvizëshme. Skeleti metalik duhet të mbulohet me material druri me përmasa 8x5cm.	68 x 126 x 16cm	1	Copë

16.Poltron rrotullues (drejtuesi)	Karrigia duhet të jetë 63cm x 118cm në pozicionin e ulur dhe në pozicionin e ngritur 63cmx126cm. Karrigia duhet të jetë një trup, ndenjësja dhe mbështetësja. Ndenjësja duhet të jetë 48x55cm. Mbështetësja duhet të jete 54cm x 77cm. Krahët edhe bazamenti duhet të jenë me material metalik të kromuar. Krahët duhet të jenë 6cmx32cm me veshje. Karrigia duhet të ketë në anën e djathtë një levë e cila kryen funksionin e uljes dhe ngritjes, ndërsa në anën e majtë të ketë një levë ku kryen funksionin e lëvizjes para mbrapa. Karrigia duhet të mbështetet në materialin e kromuar të bazamentit yll ku secila dalje e yllit duhet të jetë e mbështetur në rrota plastike të veshura me gominë të holle për të minimizuar zhurmat dhe gërvishtjet në sipërfaqe të ndryshme. Karrigia duhet të jetë prej materialit lëkure ekologjike cilësore.	63 x 118cm	1	Copë
17.Poltron (karrike) rrotullues me bazament dhe krah mbështetës metalik	Karrigia duhet të jetë një trup, ndenjësja dhe mbështetësja. Karrigia duhet të jetë e pajisur me bazament dhe krahë metalik të kromuar. Përmasat e karriges duhet të jenë 56x98x104cm, ku ndenjësja duhet të jetë me përmasa 49x54cm dhe mbështetësja duhet të jetë 47x62cm e veshur me lëkurë ekologjike. Krahët duhet të jenë metalik të kromuar dhe të veshur me lëkurë ekologjike. Bazamenti në formë yll metalik i kromuar I pajisur me rrotat plastike. Karrigia dueht të ketë mekanizëm që shërben për ulje-ngritje të karriges me anë të një pistoni me gaz si dhe funksionin e relaksit para dhe pas	56 x 98 x 104cm	22	Copë
18.Raft metalik për arkivë	Rafti metalik duhet të jetë me përmasa 100x42x250cm. Krahët duhet të jenë me material metalik të dhëmbëzuar për të vendosur raftet. Ndarësja duhet të jetë e përbërë nga 2 trarë mbajtës me kapëse dhe llamarina të dallgezuar që shërbejnë për të mbajtur pesha deri ne 150-180 kg për çdo ndarje.	100 x 42 x 250cm	6	Copë

Specifikimet teknike të mësipërme janë hartuar nga AK në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Këto Specifikime janë parashikuar duke patur parasysh nevojat konkrete që ka AK për artikujt objekt të prokurimit, për të pajisur punonjësit e ERE-s me pajisjet përkatëse. Ato përmbajnë përshkrime të përgjithshme, karakteristika sasiore, cilësore dhe në përmasat përkatëse.

Këto specifikime teknike të vendosura janë plotësisht të realizueshme nga OE që veprojnë në treg, operatorë ekonomikë prodhues apo importues të pajisjeve të mobilimit.

Transporti i pajisjeve të mobilimit, montimi dhe vendosja e tyre në ambjentet përkatëse të ERE-s, do të realizohet nga operatori ekonomik me të cilin AK do të nënshkruajë kontratën e furnizimit.

NJËSIA E PROKURIMIT